



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M
K.P.P. 520/2019

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 02.08.2019 shqyrtoi ankesat përkatësisht me:

- Objekt:** “Shfuqizim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në lidhje me kualifikimin e operatorit ekonomik “Signs & Road Safety Solutions” sh.p.k., në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me nr. REF-17473-04-10-2019, me objekt, “*Materiale për sinjalistikë (Tabela)*”, me fond limit 16.681.000 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datë 06.05.2019, nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme Nr.2 e Punëtorëve të Qytetit Tiranë.
- Ankimues:** “Si.Si-AL” sh.p.k.
Autostrada Tiranë – Durrës, Km.4, Tiranë
- Autoriteti Kontraktor:** Drejtoria e Përgjithshme Nr.2 e Punëtorëve të Qytetit Tiranë
Rruga “5 Maji”, Tiranë
- Baza Ligjore:** Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “*Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksonimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoji relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar.

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar.

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 11.04.2019, është publikuar nga autoriteti kontraktor, në faqen e internetit të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me nr. REF-17473-04-10-2019, me objekt, “*Materiale për sinjalistikë (Tabela)*”, me fond limit 16.681.000 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datë 06.05.2019, nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme Nr.2 e Punëtorëve të Qytetit Tiranë.

II.2. Në datën 06.05.2019, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

II.3. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE) si dhe referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor në datë 17.05.2019 ka kryer vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesmarrës në këtë procedurë prokurimi të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. “Signs & Road Safety Solutions” sh.p.k. 6.716.050 lekë, skualifikuar
2. “Jubica” sh.p.k. 14.500.000 lekë, skualifikuar

- | | |
|-----------------------------------|-------------------------------|
| 3. "Si.Si - AL" sh.p.k. | 15.031.000 lekë, kualifikuar |
| 4. "RSM Company" sh.p.k. | 15.885.545 lekë, skualifikuar |
| 5. "I.D.K - Konstruksion" sh.p.k. | 16.599.500 lekë, skualifikuar |

II.4. Gjithashtu, nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE) si dhe referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, rezulton se autoriteti kontraktor në datë 31.05.2019 ka kryer ri-vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesmarrës në këtë procedurë prokurimi, si më poshtë vijon

- | | |
|--|-------------------------------|
| 1. "Signs & Road Safety Solutions" sh.p.k. | 6.716.050 lekë, kualifikuar |
| 2. "Jubica" sh.p.k. | 14.500.000 lekë, skualifikuar |
| 3. "Si.Si - AL" sh.p.k. | 15.031.000 lekë, kualifikuar |
| 4. "RSM Company" sh.p.k. | 15.885.545 lekë, skualifikuar |
| 5. "I.D.K - Konstruksion" sh.p.k. | 16.599.500 lekë, skualifikuar |

II.5. Operatori ekonomik "Si.Si - AL" sh.p.k. në datën 07.06.2019 ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar kualifikimin e operatorit ekonomik "Signs & Road Safety Solutions" sh.p.k., në procedurën e mësipërme të prokurimit. Konkretisht operatori ekonomik ankimes pretendon si më poshtë vijon:

[...] Po ti referohemi Nr 1, Date 10.01.2007 "PER RREGULLAT E PROKURIMIT PUBLIK" I ndryshuar, Kreu V i saj, pika 4, germa "e" eshte percaktuar dhe shprehur shume qarte menyra e vleresimit te ofertave dhe kur nje oferte konsiderohet anomalisht e ulet. Ne kete germe shprehimisht thuhet: "Ne rastin kur jane te vlefshme dy ose me pak oferta, ne perputhje me nenin 56, te LPP-se, oferta vleresohet anomalisht e ulet kur ajo eshte ulur me shume se 40 perqind e fondit limit te perllogaritur. Ne rastin kur jane te vlefshme tre ose me shume oferta, ne perputhje me nenin 56 te LPP-se oferta vleresohet anomalisht e ulet nese vlere e saj do te jete me e vogel se 80 perqind e mesatares se ofertave te vlefshme. Nese nje apo disa oferta vleresohen si anomalisht te uleta, komisioni i vleresimit duhet te kerkoje sqarime nga ofertuesit, perpara se te marre vendim per kualifikimin ose jo te tyre, ne perputhje me nenin 56, te LPP-se".

Nisur nga ky perkufizim ligjor i shprehur shume qarte ne VKM Nr I date 10.01.2017, I ndryshuar oferta e paraqitur dhe e kualifikuar nga shoqeria Signs & Road Safety Solution eshte anomalisht e ulet, pasi eshte me teper se 40 % me e vogel se fondi limit i cili per tenderin ne fjale eshte 16,681,000 leke dhe oferta e shoqerise Signs & Road Safety Solution eshte 60 % me e ulet (6,715,975/16,681,000

Mbeshtetur ne sa, ne keto anomali dhe mosperputhshmeri si me siper si dhe referuar ligjeve ne fuqi, sipas mendimit tone komisioni i vleresimit te ofertave duhet te kishte pare keto anomali te dukshme dhe duhet ti kishte analizuar per te kuptuar vertetesine e tyre dhe ne perfundim do te duhej te vendoste skualifikimin e kesaj oferte si anomalisht te ulet.

Kompania "SI.SI-AL" pas leximit dhe kuptimit te dokumentacion te tenderit ka ofertuar duke respektuar kerkesat nga AK duke perfshire dokumentacionin si me poshte:

- *Katalogu i adezivit, Tabelave dhe Tubave te cili detajon specifkimet e produkteve te kerkuara. (Dokumentacion dorezuar pranë AK si pjese e dokumentacionit permbushjen e specifkimeve teknike).*

- *Deklaratat e performances per adeziv te cilat mbulojne ndricimin me performance Kalsi B1 dhe B2 me factor 6.1 bazuar sistemin e testimit ETA 11/0521, ETA 11/0522, ETA 13/0303 me koeficient reflektimi Klasi R2, R3A+ R3B (Dokumentacion dorezuar prane AK si pjese e dokumentacionit permbushjen e specifikimeve teknike).*

Bazuar ne sa me siper kerkojme nga ana juaj skualifikimin e ofertes te shoqerise Signs & Road Safety Solution si anomalisht e ulet dhe rishqyrtimin e dokumentacionit te ketij operatori, pasi mendojme qe nuk respekton kerkesat e AK.

II.6. Referuar ankesës së operatorit ekonomik ankimes si dhe dokumentacionit bashkëngjitur saj, të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe informacionit dhe dokumentacionit të dorëzuar pranë KPP nga autoriteti kontraktor, ky i fundit në datën 13.06.2019, me anë të shkresës nr.1071/7 prot., i ka kthyer përgjigje ankesës së operatorit ekonomik ankimes duke e refuzuar atë, me argumentin si më poshtë:

“[...] Nga shqyrtimi i ankeses prej Komisionit te Shqyrtimit te Ankesave rezultoi se Shoqeria "SI.SI-AL" shpk kundërshton kualifikimin e shoqerise "Signs Road Safety Solutions" shpk, me argumentimin se oferta e paraqitur nga kjo shoqeri ("Signs Road Safety Solutions" shpk) eshte anomalisht e ulet dhe per kete arsye KVO-ja duhet te kishte analizuar oferten e paraqitur dhe nuk duhet ta kishte kualifikuar.

I. Në lidhje me argumentin e mesiperm, KSHA-ja u njoh me dosjen e tenderit procesverbalin e rivleresimit dhe me dokumentacionin bashkëngjitur qe ka sherbyer per marrjen e vendimit te kualifikimit te shoqerise "Signs & Road Safety Solutions" shpk, mbajtur nga KVO-ja.

KVO-ja ka konstatuar se oferta e shoqerise "Signs & Road Safety Solutions" shpk eshte anomalisht e ulet dhe per kete arsye, ne zbatim te nenit 56 te Ligjit Nr.9643, date 20.11.2006 "Per Prokurimin Publik", i ndryshuar dhe te nenit 66, pika 4 dhe 5 te VKM-se Nr.914, date 29.12.2014 "Per miratimin e rregullave te prokurimit publik" i ndryshuar, i ka derguar ne date 29.05.2019 kerkese zyrtare per argumentimin e ofertes ekonomike.

Ne daten 31.05.2019, OE "Signs & Road Safety Solutions" ka protokolluar pranë autoritetit kontraktor argumentimin e kerkuar.

KSHA veren se perllogaritja e ofertes ekonomike nga ana e OE, se pari mbeshtetet ne oferten zyrtare te paraqitur nga prodhuesi (Tamburrini Alessandro s.r.l), i cili ka leshuar dhe autorizim prodhuesi, paraqitur ne tender. Ne oferten ekonomike te prodhuesit jepen te gjitha cmimet per zerat e kerkuar ne shtojcen 12 "Sasia dhe grafiku i levrimin" te dokumentave standartet te tenderit. Gjithashtu eshte perllogaritur transporti i tyre, kostot administrative dhe fitimi i kompanise. Nisur nga perllogaritja e paraqitur, KSHA vlereson se argumentimi i ofertes ekonomike qendron. Si rrjedhim, KSHA vendosi te mos pranoje pretendimin e shoqerise "SI.SI-AL" shpk.

II.7. Në datën 21.06.2019 operatori ekonomik “Si.Si - AL” sh.p.k. ka paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik duke ngritur të njëjtat pretendime si në ankesën e paraqitur pranë autoritetit kontraktor.

II.8. Nëpërmjet shkresës nr. 1071/20 prot., datë 03.07.2019, protokolluar me tonën në datën 05.07.2019, me objekt “Dërgim informacioni për procedurën e prokurimit me objekt “Materiale për sinjalistikë (Tabela)”, REF-17473-04-10-2019”, është depozituar në Komisionin e

Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit dhe trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimes.

Autoriteti kontraktor në informacionin dhe dokumentacionin e depozituar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, sqaron se:

[...]

Në datën 17.05.2019, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka bërë vlerësimin e procedurës së prokurimit dhe renditjen e operatorëve si më poshtë:

1. *Signs & Road Safety Solutions” sh.p.k. skualifikohet për shkak se nuk përmush pikën 2.3.2 të kapacitetit teknik ku thuhet se: “Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi/distributori i autorizuar për mallin objekt prokurimi. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, ëbsite kjo e nevojshme për autoritetin kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij”, pasi nuk ka paraqitur autorizim nga prodhuesi/distributor i autorizuar për adezivin, edhe pse ka paraqitur dokumentacion teknik (skedë teknike) nga firma “3 M”, firmë e cila prodhon adeziv.*

[...]

Në datën 21.05.2019 OE “Signs & Road Safety Solutions” sh.p.k. ka paraqitur ankesë pranë DPN2PQ me nr. 1071/6 prot., datë 21.05.2019 ku kundërshton skualifikimin e tij me argumentin se ka paraqitur autorizim prodhuesi nga kompania italiane “Tamburini Alesandro” e cila tregton tabela rrugore, tuba çeliku për tabela rrugore, aksesore dhe se tabelat i vijnë të gatshme me të gjithë elementët e kërkuar nga kjo kompani.

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave pasi ka marrë në shqyrtim këtë ankesë ka vendosur të pranojë pretendimin e ngritur nga OE...

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pasi u njoh me vendimin e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave verifikoi ofertën ekonomike të OE “Signs & Road Safety Solutions” sh.p.k. për gabime aritmetike dhe aplikoi formulën e ofertës anomalisht të ulët, ku rezultoi se oferta është anomalisht e ulët dhe me gabime aritmetike. Në këto kushte KVO-ja nëpërmjet SPE-së në datë 29.05.2019 i ka dërguar kërkesë për argumentimin e ofertës ekonomike dhe konfirmim për korrigjimin e gabimeve të konstatuara.

Në datë 31.05.2019 OE “Signs & Road Safety Solutions” sh.p.k. ka kthyer përgjigje me shkresën nr. 1071/12 prot., datë 31.05.2019 me ofertë të korrigjuar në vlerën 6.715.975 lekë pa tvsh.

KVO-ja pasi mori në shqyrtim argumentimin e paraqitur nga OE, bëri rivlerësimin e procedurës dhe renditjen e ofertave[...].

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, si edhe informacionit dhe dokumentacionit të autoritetit kontraktor

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Si.Si - AL” sh.p.k. për skualifikimin e operatorit ekonomik “Signs & Road Safety Solutions” sh.p.k. me arsyetimin se: *“[...] oferta e paraqitur dhe e kualifikuar nga shoqeria Signs & Road Safety Solution është anomalisht e ulët, pasi është me teper se 40 % me e vogël se fondi limit i cili për tenderin në fjalë është 16,681,000 leke dhe oferta e shoqerisë Signs & Road Safety Solution është 60 % me e ulët (6,715,975/16,681,000*

Mbeshtetur në sa, në këto anomali dhe mosperputhshmeri si me sipër si dhe referuar ligjeve në fuqi, sipas mendimit të komisioni i vlerësimit të ofertave duhet të kishte parë këto anomali të dukshme dhe duhet të kishte analizuar për të kuptuar vertetësinë e tyre dhe në përfundim do të duhej të vendoste skualifikimin e kësaj oferte si anomalisht të ulët[...]. Bazuar në sa me sipër kërkojmë nga ana juaj skualifikimin e ofertës të shoqerisë Signs & Road Safety Solution si anomalisht të ulët dhe rishqyrtimin e dokumentacionit të këtij operatori, pasi mendojmë që nuk respekton kërkesat e AK”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në nenin 56 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se *“[...] 1. Kur autoriteti kontraktor vëren se një ose më shumë oferta për kontratat e mallrave, punëve apo shërbimeve janë anomalisht të ulëta, ai, përpara se të vazhdojë me procesin e vlerësimit të ofertave, i kërkon operatorit ekonomik përkatës të paraqesë me shkrim dhe brenda 3 ditëve pune shpjegime për elemente të veçanta të ofertës, për:*

- a) anën ekonomike të metodës së ndërtimit, procesit të prodhimit ose të shërbimeve të ofruara;*
- b) zgjidhjet teknike të ofruara dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm, që ka ofertuesi për kryerjen e punimeve, për furnizimin e mallrave apo të shërbimeve;*
- c) origjinalitetin e punëve, mallrave apo të shërbimeve, të propozuara nga ofertuesi;*
- ç) zbatueshmërinë e detyrimeve, që lidhen me mbrojtjen në punë dhe kushtet e punës, në vendin ku do të kryhet puna, shërbimi apo ku do të sigurohet furnizimi.*

2. Autoriteti kontraktor i verifikon këto elemente duke u këshilluar me ofertuesin dhe në bazë të informacionit të paraqitur. Autoriteti kontraktor mund ta refuzojë ofertën, kur edhe pas shqyrtimit të informacionit të paraqitur nga ofertuesi, nuk bindet se ajo është e rregullt në të gjitha elementet e saj[...].”

III.1.2. Në nenin 66 pika 5 të VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, parashikohet se: *“Pas korigjimit të gabimeve aritmetike, komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon nëse ofertat e vlefshme janë ose jo me çmim anomalisht të ulët sipas formulës së përcaktuar në dokumentet standarde të tenderit. Përlllogaritja e ofertës anomalisht të ulët bëhet në mënyrat e mëposhtme: Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 56 të LPP, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25% e fondit limit të përlllogaritur. Në rastin kur janë të vlefshme tre ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 56 të LPP, oferta vlerësohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme. Nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, komisioni I vlerësimit të ofertave duhet të kërkojë sqarime nga ofertuesit, përpara se të marrë vendim për kualifikimin ose jo të tyre, në përputhje me nenin 56 të LPP.*

Në çdo rast ofertuesi ka detyrimin të argumentojë dhe të dokumentojë me prova shkresore sqarimet për elementin/elementet e veçanta të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 56 të LPP [...]”.

III.1.3. Nga interpretimi literal i nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se barra e provës mbi argumentin e ofertës anomalisht të ulët i përket operatorit ekonomik, oferta e të cilit është konstatuar nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave dhe në zbatim të VKM 914/2014. Gjithashtu, K.P.P. gjykon se argumentimi i ofertës anomalisht të ulët njëherazi duhet të plotësojë katër kushte kumulative për ti dhënë garanci si edhe bindje autoritetit kontraktor. Së pari, operatori ekonomik ankimues duhet të dorëzojë në mënyrë të detajuar anën ekonomike të metodës së ndërtimit, procesit të prodhimit ose të shërbimeve të ofruara, gjithashtu duhet të paraqesë para autoritetit kontraktor zgjidhjet teknike të ofruara si edhe në raste të veçanta dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm, që ka ofertuesi për kryerjen e punimeve, për furnizimin e mallrave apo të shërbimeve. Gjithashtu është detyrë e operatorëve ekonomikë oferta e të cilëve është konstatuar anomalisht e ulët të paraqesin prova shkresore para autoritetit kontraktor në lidhje me origjinalitetin e punëve, mallrave apo të shërbimeve, të propozuara nga ofertuesi, si edhe së fundmi duhet të vërtetojë zbatueshmërinë e detyrimeve, që lidhen me mbrojtjen në punë dhe kushtet e punës, në vendin ku do të kryhet puna, shërbimi apo ku do të sigurohet furnizimi. K.P.P. gjykon se katër kushtet e mësipërme të parashikuara nga lex specialis janë kushte kumulative të cilat më anë të provave shkresore dhe argumentimeve përkatëse duhen plotësuar nga operatorët ekonomikë ankimues, oferta e të cilëve rezulton anomalisht e ulët. Referuar nenit 56 pika 2 të LPP-së autoriteti kontraktor i verifikon këto elemente duke u këshilluar me ofertuesin dhe në bazë të informacionit të paraqitur. Autoriteti kontraktor mund ta refuzojë ofertën, kur edhe pas shqyrtimit të informacionit të paraqitur nga ofertuesi, nuk bindet se ajo është e rregullt në të gjitha elementet e saj. K.P.P. gjykon se nga interpretimi teleologjik i normës së mësipërme (qëllimi i saj) lidhet drejtpërdrejtë me shmangijen e riksut që mund të sjellë një ofertë e cila rezulton anomalisht e ulët. K.P.P. gjykon se risku që shfaqet në rast se një ofertë rezulton anomalisht e ulët është në disa drejtime ku ndër të tjera si: rreziku për mos kryerjen e shërbimit/punëve në cilësinë e duhur; rreziku i tërheqjes së operatorit ekonomik nga lidhja e kontratës dhe kosto që i lindin autoritetit nga mos kryerja e shërbimit brenda afateve kohore të parashikuara; humbjet që mund të pësojë në kohë nga mos kryerja e shërbimit gjatë periudhës së ri publikimit të procedurës së tenderit në rast të mos zbatimit të kontratës nga ana e operatorit ekonomik oferta e të cilit rezulton anomalisht e ulët. Gjithashtu, K.P.P. thekson se referuar nenit 1 gërma “b” “Objekti dhe qëllimi” i ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se “Objekt i këtij ligji është përcaktimi i rregullave që zbatohen për prokurimet e mallrave, të punëve dhe të shërbimeve nga autoritetet kontraktore të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; Mirëpërdorimi i fondeve publike përfshin jo vetëm përzgjedhjen nga autoriteti kontraktor të ofertave më të ulëta (si kriter i përzgjedhjes së ofertës fituese referuar “çmimit më të ulët”), por gjithashtu shmangien e risqeve dhe dështimin e kontratës që mund të vijnë nga oferta të cilësuar si anomalisht të ulëta, referuar formulës së përlogaritjes të parashikuar në ligj”.

III.1.4. Komisioni i Prokurimit Publik verifikoi ofertën ekonomike të operatorit ekonomik “Signs & Road Safety Solutions” sh.p.k., dhe nga ky verifikim rezulton se, nga ana e këtij të fundit është paraqitur oferta ekonomike, plotësuar sipas zërave të kërkuara nga autoriteti kontraktor.

Nga llogaritjet e kryera nga Komisioni i Prokurimit Publik, referuar bazës ligjore si më sipër cituar (shiko pika III.1.2.), rezulton se oferta e operatorit ekonomik “Signs & Road Safety Solutions” sh.p.k., është anomalisht e ulët dhe sipas informacionit të autoritetit kontraktor, rezulton se edhe Komisioni i Vlerësimit të Ofertave e ka konstatuar këtë fakt, dhe ka kërkuar që nga operatori ekonomik të paraqitej analiza e çmimeve të ofruara. Nga shqyrtimi i informacionit dhe dokumentacionit të paraqitur nga autoriteti kontraktor rezulton se nga ana e operatorit ekonomik “Signs & Road Safety Solutions” sh.p.k., me synim justifikimin/argumentimin e ofertës anomalisht të ulët është dorëzuar dokumenti, datë 30.05.2019 “Kthim përgjigje referuar kërkesës për argumentimin e ofertës ekonomike” për analizën e çmimeve të ofertës së paraqitur prej tij.

III.1.5. Nisur nga sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim argumentimet e ofertës ekonomike, të paraqitura nga shoqëria “Signs & Road Safety Solutions” sh.p.k. Sipas informacionit dhe dokumentacionit të paraqitur nga autoriteti kontraktor rezulton se, me synim justifikimin/argumentimin e ofertës anomalisht të ulët, nga ana e operatorit ekonomik “Signs & Road Safety Solutions” sh.p.k., është dorëzuar dokumenti “Kthim përgjigje referuar kërkesës për argumentimin e ofertës ekonomike” ku është argumentuar në lidhje me ofertën e tij, shoqëruar edhe me faturën e blerjes nga furnitori (kompania Tamburrini Alessandro S.r.l), por nga analiza e kryer rezulton se ka mangësi në lidhje me dokumentacionin e paraqitur për zërat që përfshihen në ofertë të tilla si: për zërin me numër rendor 9, diferenca ndërmjet çmimit të ofertuar dhe çmimit kosto për njësi është me vlerë negative, ç’ka do të thotë që operatori ekonomik “Signs & Road Safety Solutions” sh.p.k. nuk garanton autoritetin kontraktor se mund të marrë përsipër realizimin me sukses të kontratës së furnizimit. Gjithashtu, nga vlerësimi i dokumentacionit të administruar, nga ana e ofertuesit nuk rezulton të jenë parashtruar të dhëna, fakte apo garanci në referim nenit 56 të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, duke mos u paraqitur ndonjë dokument tjetër, që të argumentojë kushtet apo elementët e favorshëm pse kjo ofertë anomalisht e ulët nuk krijon asnjë rrezik për mosrealizimin me sukses të kontratës, pasi provueshmeria e këtij kriteri është esenciale duke garantuar autoritetin kontraktor jo vetëm për realizimin e furnizimeve, por për realizimin e tyre sipas standarteve të kërkuara në cilësi dhe sasi dhe me çmimin konkurues të ofertuar. Bazuar në arsyetimin dhe faktet e shtjelluara më lart, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se nga ana e operatorit ekonomik, oferta e të cilit në zbatim të formulës të përcaktuar në legjislacion ka dalë anomalisht e ulët, janë paraqitur sqarime dhe dokumentacion jo bindës që të argumentojnë ofertën anomalisht të ulët (në kuptim të: metodës së përzgjedhur, zgjidhjeve teknike të posaçme, kushte përjashtimisht favorizuese që gëzon ofertuesi apo origjinaliteti i punës së propozuar), duke mos krijuar bindjen se kjo ofertë është e rregullt në të gjithë elementët e saj me qëllim garantimin e një kontrate të suksesshme.

Rrjedhimisht, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “Si.Si - AL” sh.p.k. qëndron.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Si.Si - AL” sh.p.k. për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me nr. REF-17473-04-10-2019, me objekt, “*Materiale për sinjalistikë (Tabela)*”, me fond limit 16.681.000 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datë 06.05.2019, nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme Nr.2 e Punëtorëve të Qytetit Tiranë.
2. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së për kualifikimin e operatorit ekonomik “Signs & Road Safety Solutions” sh.p.k. dhe të korrigjojë shkeljet e konstatuara si më sipër, duke e skualifikuar këtë operator ekonomik.
3. Autoriteti kontraktor brenda 10 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet për kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Si.Si - AL” sh.p.k.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 1133 Protokolli

Datë 21.06.2019

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar	Anëtar	Anëtar	Anëtar
Enkeleda Bega	Vilma Zhupaj	Lindita Skeja	Merita Zeqaj

Kryetar
Evis Shurdha